

Relacion

Janar- Qershor 2017

Punoi :

Artida AVDIA

Specialiste e Edukimit ne Vazhdim, UFSH

Relacion Edukimi në Vazhdim Janar – Qershor 2017

Urdhri i Farmacisteve të Shqipërisë, ka për mision edhe ngritjen profesionale të farmacisteve. Nga UFSH kjo është realizuar nëpërmjet hartimit dhe planifikimit të programeve të kualifikimit të vazhdueshëm. Nga analiza që QKEV ka bërë, UFSH rezulton se është ofruesi kryesor për aktivitetet e edukimit në vazhdim për farmacistet në vend.

Për të përmbushur sa më mirë detyrimin tonë me profesionistët farmacistë kemi ofruar aktivitete nëpër të gjitha rajonet e Shqipërisë, bazuar edhe në numrin e farmacistëve dhe nevojat për kredite për secilin rajon.

Gjithashtu, për të disajtin vit, jemi mbështetur në marrëveshjen e bashkëpunimit që kemi me qendrën e “Telemedicinës” pranë QSUT e cila, na ka vendosur në dispozicion pa pagesë sallat e saj në Tiranë dhe në të gjitha rajonet e Shqipërisë, për zhvillimin e **Videokonferencave**. Videokonferencat janë një metodë mjaft efikase për të ulur në maksimum kostot për secilin aktivitet dhe për të shtuar numrin e krediteve të ofruara për secilin rajon. Duke shfrytëzuar këtë mundësi të ofruar nga Qendra e Telemjekësisë së Shqipërisë, seminarët këtë vit i kemi ofruar në të gjitha rajonet e Shqipërisë duke përfshirë dhe dy zona të skajshme sic është Saranda dhe Tropoja. Gjatë këtij 6 mujori UFSH ka ofruar **70 kredite**. Prej të cilave **21 kredite** (prej 15 mesatarisht të nevojshme në një vit) janë ofruar drejtëpërdrejtë nga UFSH me anë të videoleksioneve për secilin rajon të Shqipërisë, aktivitete të cilat për rajonin e Tiranës, si rajoni me numrin më të madh të pjesëmarrësve, çdo aktivitet është përsëritur 2 herë. Ajo e cila vlen të theksohet se sikurse vitin e kaluar është fakti që këto seminare janë ofruar **pa pagesë** për farmacistët. Këtë vit UFSH, për ta patur më të lehtë nga ana logjistike të gjitha aktivitetet e ofruara nëpërmjet “Telemedicinës” i ka zhvilluar çdo ditë të premte nga ora 09:00-12:15 duke filluar nga data 17 Shkurt deri me datën 16 Qershor. Pra, duke e quajtur ditën e premte “E premtja e Urdhrit”. Këtë vit UFSH solli si risi edhe bashkëpunimin me një koordinator shkencor të jashtëm, përfaqësues i fushës akademike, **Prof. Ledjan Malaj**, bashkëpunimi me të cilin mund të konsiderohet tepër i sukseshmëm pasi lektorët dhe temat e përzgjedhura rezultuan të vlerësuar dhe me interes për pjesëmarrësit.

Në kuadër të Edukimit në Vazhdim, por edhe në funksion të rritjes së cilësisë së tij si dhe shtrirjes së bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë si brenda vendit dhe jashtë tij, UFSH ka qenë bashkëorganizatore me Albanian University, me Oden e Farmacisteve të Kosovës si dhe me Organizatën Studentore “Brainstorm” në të cilat u ofruan përkatësisht **9,20 dhe 20 kredite**.

Në këto aktivitete morën pjesë, lektorët më në zë të universiteteve të Milanos, Napolit, Pizës e sigurisht të Shqipërisë. Konkretisht UFSH i mbështeti këto aktivitete në procedurat e akreditimit pranë Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim apo duke mbuluar zëra të parapërcaktuar në kontratat e bashkëpunimit të firmosura paraprakisht midis palëve organizatore.

Vlen të nenvijezohet bashkëorganizimi i Konferencës së II-te Karmaceutike të Kosoves të UFSH, e cila u zhvillua në datat 2,3,4 Qershor dhe ofroi 20 kredite. Me prezencën në këtë konferencë pjesëmarrësit përveç krediteve përfituan edhe nga një dosje me material didaktike cilësore përfituan edhe ftesën për darkën gala të organizuar me këtë qëllim.

Problematikat e hasura nëpër aktivitetet e edukimit në vazhdim vihet re se janë të përsëritura ndër vite, dhe janë:

- Pjesëmarrje fiktive vecanerisht neper rajone
- Probleme teknike në disa prej qyteteve, ku mund të përmendim Saranden, Tropojen dhe Vlorën.

Sikurse është vepruar edhe më parë, pranë QKEV janë dërguar lista të diferencuara në varësi të orëve të qëndrimit, një mënyrë e përdorur për të mbajtur pjesëmarrësit present.

Përsa i përket përmirësimit të lidhjeve direkte me qytetet e sipërpërmendura është biseduar me përfaqësuesit e Qendres së Telemedicines, të cilët na kanë premtuar përmirësim të bashkëpunimit në qytetet me problematike.

Vihet re se, për shkak edhe të ofrimit të një numri të konsiderueshëm kreditesh por edhe të shkurtimit të orarit të këtyre aktiviteteve, pjesëmarrja në këto aktivitete është më e rritur dhe më reale, gjë e cila ka qenë tepër problematike në vitet paraardhëse.

Për gjysmën e dytë të këtij viti parashikojmë përsëritjen e disa prej aktiviteteve të zhvilluara në pjesën e parë të vitit për të gjithë personat që nuk e patën mundësinë të ndiqnin, si dhe planifikojmë ngritjen e një tjetër kursi online, të cilin pjesëmarrësit mund ta ndjekin dhe ta zhvillojnë në ambjentet ku punojnë apo ushtrojnë profesionin.

Bashkelidhur po mund të gjeni kalendrin e aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim për periudhën Janar-Qershor 2017.

Mirëpresim çdo vërejtje apo sugjerim nga ana Juaj!

Specialiste Edukimit Vazhdim

Artida Avdia